



Blaise Pascal dhe Ibn Kajim el-Xheuzijeh rreth ekzistencës së Zotit

Description

Rezart Beka

Blaise Pascal (1623 –1662) është i njohur në historinë perëndimore si një matematicien dhe fizikan i jashtëzakonshëm, shpikës dhe kontribues i shquar në shkencat ekzakte, si edhe si një filozof i mirënjohur i krishterë. Falë një vegimi fetar në vitin 1654, besimi i Paskalit në fenë e krishterë, më saktësisht në Jansenizëm, u ripërtëri dhe meditimet e tij mbi fenë dhe ekzistencën e Zotit i dhanë jetë dy veprave të rëndësishme në filozofinë e fesë, më saktësisht veprës “Letrat Provinciale” (*Lettres provinciales*) dhe veprës tjetër të publikuar pas vdekjes së tij “Mendimet” (*Pensées*).

Veçanërisht në veprën e tij të fundit, Pascali ofron një argument në favor të besimit në Zot, i cili njihet ndryshe si “Basti i Paskalit”. Ky argument është një përpjekje e tij për të kontribuar në temën e epistemologjisë fetare. A është, apo jo, rationale të besosh në Zot? A është patjetër e nevojshme që të kemi argumente të pakundërshtueshme dhe intelektualisht bindëse për të besuar në Zot?

Në historinë e filozofisë së fesë kanë ekzistuar përgjigje të ndryshme ndaj pyetjeve të tilla. Gjithsesi, nga ana epistemologjike në filozofinë e fesë qasja ndaj çështjes së ekzistencës së Zotit është përmbledhur në dy forma racionalitetesh, ai që quhet racionaliteti epistemologjik (*epistemic rationality*) dhe racionaliteti i matur (*prudential rationality*). Racionaliteti epistemologjik mbështetet në prova dhe argumente si edhe në idenë se për të përqafuar një besim është e nevojshme të ofrohen prova racioanalisht dhe intelektualisht bindëse. Një person i cili i përqafton bindje të caktuara vetëm pasi ka hetuar intelektualisht besueshmërinë e tyre konsiderohet si një person që ndjek rrugën e racionalitetit epistemologjik. Por ka edhe një mënyrë tjetër se si një person mund të përkrahë disa besime të caktuara në vend të disa të tjerave. Kjo mënyrë tjetër konsiston në pragmatizmin dhe maturinë, që do të thotë nëse një person, pavarësisht pamundësisë për të ofruar argumente të pakundërshtueshme, beson se përkrahja e një besimi apo bindjeje të caktuar është në të mirën e tij dhe se ai nuk ka asgjë për të humbur nëse vepron sipas këtyre besimeve, atëherë ai është i justifikuar për t’i përkrahur ato në bazë të racionalitetit të matur (*prudential rationality*).

Pascali argumenton se ekzistojnë argumente të forta pragmatike dhe të matura përse duhet të besojmë në ekzistencën e Zotit. Për sa i përket çështjes nëse ia vlen apo jo të besojmë në Zot, Pascal shprehet:

“Le ta shqyrtojmë këtë çështje dhe le të themi: Zoti ose ekziston ose jo. Por ndaj cilës prej alternativave do të ishe i prirur? Arsyeja nuk mund të vendosë në lidhje me këtë çështje. Kaosi i pafund na ndan. Në njërin skaj ekstrem të kësaj distance të pafundme një monedhë është hedhur në rretullim dhe do të ndalojë në kokë apo pil. Për cilën do të vinit bast? Arsyeja nuk mund tju bëjë të vendosni në favor as të njëres dhe as të tjetres mundësi, arsyeja nuk mund të provoj se ndonjëra prej dy mundësive është zgjedhja e gabuar...ti duhet të vësh bast. Nuk ka zgjidhje tjetër, ju jeni përkushtuar tashmë. Cilën alternativë do të zgjidhni atëherë?...Meqenëse një zgjedhje duhet bërë, le të shohim se cila prej dy zgjedhjeve të ofron interesin më të pakët. Ti ke dy gjëra për të humbur: të vërtetën dhe të mirën; dhe dy gjëra për të vënë në rrezik: arsyen dhe vullnetin tënd si edhe dijen dhe lumturinë tënde. Po ashtu, natyra jote ka dy gjëra të cilave duhet ti shmangë: gabimin dhe mjerimin. Meqenëse të duhet patjetër të zgjedhësh, arsyeja jote nuk fyhet më nëse zgjedh njërin alternativë në vend të tjetres. Kjo pikë është qartësuar tashmë? Po përse i përkët lumturisë tënde? Le të peshojmë përfitimin dhe humbjen e mundshme nëse hedhim bast se monedha do bie kokë në favor të ekzistencës së Zotit. Le ti vlerësojmë të dy rastet. Nëse ti fiton ke fituar gjithçka, nëse humbet nuk ke humbur asgjë. Atëherë mos hezito, vëre bastin në favor të ekzistencës së Zotit.[1]

Pra sipas argumentit të Pascalit, është pragmatike dhe e urtë që njeriu të besoj në ekzistencën e Zotit dhe të botës tjetër në mënyrë që të jetë i sigurtë për çdo rast, sepse nëse Zoti vërtet ekziston atëherë do të përfitojmë lumturinë e pafundme (shpëtimin në botën tejtër), por nëse ai nuk ekziston, atëherë besimi në të nuk shkaton asnjë dëm apo humbje. Ndërsa ai që nuk beson në ekzistencën e Zotit nuk është më i privilegjuar se ai që beson në Të, por nëse Zoti vërtet ekziston, atëherë ateisti ka gjithçka për të humbur. Duke qenë se arsyeja nuk mund të na ndihmojë në këtë çështje, atëherë jemi të detyruar të vëmë një bast dhe është më me përfitim dhe e matur që të vëmë bast në favor të ekzistencës së Tij[2].

Pascali konsiderohet i pari filozof feje që ka ofruar një version të tillë argumentimi për përfitimin dhe dobishmërinë e të besuarit në Zot. Mirëpo nëse do t'i hedhim një sy një prej veprave të dijetarit të mirënjohur Ibn Kajim el-Xhezijeh (1292–1350 e.r.s.) të titullaur “Medarixh el-Salikin”, do të shohim se një argument nuk ka qenë aspak i panjohur për dijetarët myslimanë. Gjatë analizës që ai i bën stacionit shpirtëror të të kapurit pas fesë së Zotit, Ibn Kajimi argumenton se besimtarët e thjeshtë kapen pas fesë së Zotit duke u mbajtur fort pas mesazhit hyjnor që i ka mbërritur. Ata i nderojnë dhe respektojnë urdhëresat dhe ndalesat e Zotit si edhe konfirmojnë të gjitha informacionet që shpallja hyjnor servir në lidhje me botën tjetër. Sipas tij, ata e bëjnë këtë duke u mbështetur në bindje të sigurt (jekin) për saktësinë e asaj që përçohet në mesazhin hyjnor dhe jo thjesht duke ndjekur hamendësime, hezituuar apo duke besuar thjesht që të jenë në anën e sigurtë[3].

Pikërisht në lidhje me këtë aspekt të fundit, d.m.th. në besimin për të qenë brenda dhe për të mos rrezikuar të “digjesh” në botën tjetër, Ibn Kajimi e paraqet argumentin e Pascalit në formën e një poezie të vjetër arabe:

“Magjistari dhe mjeku që të dy kanë pohuar

Se të vdekurit nuk do të ringjallen. Unë them: Dëgjo këtu

Nëse ju keni të drejtë, une (gjithsesi) nuk humb asgjë.

Por, nëse unë kam të drejtë ju jeni të dy humbës[4].

Në këtë poezi të shkurtër, Ibn Kajimi ka përmbledhur thelbin e “Bastit të Pascalit” dhe të argumentit të tij rreth nevojës pragmatike për të besuar në Zot, i cili mbështetet mbi racionalitetin e matur apo pragmatizmin.

Pasi citon poezinë në fjalë, Ibn Kajim ofron qendrimin tradicional Islam ndaj një logjike të tillë. Ai shprehet: *“Kjo është rruga e njerëzve të mëdyshjes dhe dyshimit, të cilët i binden udhërimit dhe ndalimit (të Zotit) si pasojë e maturisë/kujdesit. Kjo rrugë nuk të mbron nga ndëshkimi i Zotit e as suksesi nuk i vjen atyre që e zgjedhin atë si edhe një rrugë e tillë nuk i shpie ata drejt sigurisë”*[5]

Pra, për Ibn Kajimin rruga e Pascalit nuk është rruga e një besimi të vërtetë. Në mënyrë që besimi të ofrojë frytet e duhura, në këtë botë dhe tjetrën, ai duhet mbështetur në siguri dhe jo në llogaritje përfitimi dhe humbje. Besimi e përball njeriun me vështirësi dhe sfida të mëdha në jetë, të cilat për tu tejkaluar kërkojnë sakrifica dhe mundime të atilla që nuk mund të arrihen nëse njeriu nuk është i sigurtë në vërtetësinë e besimit të tij, por në vend të kësaj ai ka vendosur të besoj thjesht për të qenë në anën e sigurtë dhe për të mos rrezikuar. Ibn Kajimi argumenton se një besim i tillë nuk dërgon asnjëherë në sigurinë e shpresuar, as në suksesin e dëshiruar si edhe nuk e shpëton njeriun nga ndëshkimi hyjnor, sepse një besim i mbështetur në probabilitet dhe llogaritje pragmatike nuk konsiderohet i vlefshëm.

Rruga e ofruar nga Pascali mbështetet në një pesimizëm të madh rreth rolit të arsyes dhe intelektit njerëzor për të vërtetuar ekzistencën e Zotit dhe të jetës së përtejme, ndërsa këndvështrimi tradicional Islam ka qenë përgjithësisht optimist rreth mundësisë për të arrirë dije të sigurtë (jekin) në lidhje me ekzistencën e Zotit, madje një siguri e tillë përbën shtyllën mbi të cilën mbështetet besimi dhe vlefshmëria e tij. Siç është shprehur edhe Ismail Faruku e: *“Imani (besimi) është, kështu, “bindje”, krejtësisht e lirë prej dyshimit të gjasës, prej të hamendësuarit dhe pasigurisë. Ai është një akt dhe jo një vendim, jo një zgjidhje për t’u pranuar apo për të mbështetur besimin, jo diçka që nuk dihet në është apo jo e vërtetë, si për të vënë bast me një pasuri të tërë për njërën apo për tjetrën kuti. Imani është diçka që i ndodh njeriut, kur e vërteta, faktualiteti i një objekti e godet atë në fytyrë dhe e bind përtej çdo dyshimi për të vërtetën e vet”*[6]

Qëndrimi i Ibn Kajimit ndaj qasjes së Pascalit përmbledh në mënyrë të thukët kritikën tradicionale Islame ndaj një argumentimi të tillë, i cili fatkeqësisht shpesh shfaqet edhe në shumë ligjërata fetare, si një përpjekje për të vërtetuar “logjikisht” se besimtari në çdo rast, d.m.th. si në rastine ekizstencën së Zotit ashtu edhe në rastin e mosekzistencës së tij, nuk ka asgjë për të humbur, përkundrazi ai është gjithnjë i fituar. Qendrimi i Ibn Kajimit, ndonëse i shkurtër, shpreh qartë kritikën islame ndaj një forme të tillë argumentimi si edhe i paraprin me shumë shekuj përsiatjeve të Pascalit.

Referenca

[1] Blaise Pascal, “Pensees”, seksioni III, “Nevoja për të vënë bast”.

[2] Për më shumë në lidhje me argumentin e Pascalit, shih “Philosophy of Religion: A Reader and Guide”, ed. William Lane Craig, (Edinburgh University Press 2010), f. 7-15.

[3] Ibn Kajim el-Xheuzijeh, “Medarixh el-Salikin”, f. 288.

[4] Ibn Kajim el-Xheuzijeh, “Medarixh el-Salikin”, f. 289.

[5] Ibn Kajim el-Xheuzijeh, “Medarixh el-Salikin”, f. 289.

[6] Ismail Faruqi, “Al Tawhid- its implications for though and life”, f. 40-41.

Bibliografi

- Ibn Kajim el-Xheuzijeh, “Medarixh el-Salikin”, (Liban: Dar el-Kutub el-Ilmijeh 2010).
- Blaise Pascal, “Pensees”, (Hackett Publishing Company March 15, 2005).
- “Philosophy of Religion: A Reader and Guide” (eds.) William Lane Crraig (Edinburgh University Press 2010).
- Ismail R. Faruqi, “Al Tawhid- its implications for though and life” (United Arab Bureau; 2 edition, 1994).

Date Created

25/10/2015

Author

erasmusi